



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1350 prot

Korçë, më 30/07/2019

VENDIM

Nr. 413, datë 30.072019

PËR

MIRATIMIT TË RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE", DATAVE TË KONKURRIMIT, SI DHE TESTEVE PRAKTIKE PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT.

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë", si dhe në Urdhrin e përbashkët nr. 1, datë 7.6.2019 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2019-2020", si dhe vendimit të Departamentit të Edukimit nr. 1334, datë 29.7.2019, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.7.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"", sipas materialit bashkëngjitur.
2. Të miratojë datat **22-23 gusht**, si data të konkursit praktik për testet praktike të kandidatëve.
 - 2.1. Sekretaria mësimore brenda datës 10 gusht 2019 afishon në mjediset e fakultetit listën e aplikantëve nga U-Albania dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve në konkurs.
 - 2.2. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin do të jenë **12-20 gusht**.

- 2.3. Në datën **21 gusht** sekretaria mësimore shpall listën e aplikantëve të regjistruar për konkurrim.
3. Të miratojë testet praktike të konkursit për pranimin e kandidatëve sipas modeleve bashkëlidhur.
- 3.1. Raporti i pikëve të fituara në konkurrimin praktik dhe notës mesatare do të jetë 40% për notën mesatare dhe 60% për testet praktike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Ali Jashari

